

UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.2.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 11.8.2016, “PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS,
KANDIDATËVE ME ORGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA, MALI I ZI,
PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, SI DHE KANDIDATËVE ME STATUSIN
E TË VERBRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, TË JETIMIT, SI
DHE ROMËT DHE EGJIPTIANËT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI
DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME
KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN
AKADEMIK 2016–2017”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 18, datë 11.8.2016, togfjalëshi “me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshojë në “*me statusin e personit me aftësi të kufizuar*”.
 2. Pika 1.2.1 e kreut II, të ndryshojë në:
“1.2.2 Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë kopje të vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).”.
 3. Pika 1.2.2 e kreut II, shfuqizohet.
 4. Ngarkohet, për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla